

INFORMACION PËR FAQEN E INTERNETIT TË BKT-së BAZUAR MBI PARIMET E UDHËHEQJES SË KORPORATËS

Përditësuar më 30 shtator 2018

1. POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMIT

Mekanizmi i vendimmarrjes për shpërndarjen e fitimit tek Banka Kombëtare Tregtare ("BKT" ose "Banka") përbëhet nga rekomandimi i bërë nga Këshilli Drejtues dhe miratimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve në BKT mbahet të paktën një herë në vit, duke synuar që të miratojë pasqyrat financiare të Bankës dhe të vendosë për shpërndarjen e fitimit të vitit të fundit financiar të mbyllur.

Bazuar në vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha fitimet e realizuara nga BKT gjatë viteve financiare 2000-2015 janë kapitalizuar dhe janë përdorur nga Banka për të mbështetur zmadhimin e vazhdueshëm të bilancit dhe për të rritur fitimin.

Më 30 mars 2017 Banka realizoi shpërndarjen e parë të dividendit tek Aksioneri i saj.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të BKT është zhvilluar dy herë përgjatë vitit 2018. Mbledhja e Përgjithshme datë 27 mars 2018, miratoi rezolutën Nr. 2 si më poshtë:

"Miratohen pasqyrat financiare statutorë dhe SNRF të audituara nga "Grant Thornton" sh.p.k., për vitin financiar mbyllur më 31 dhjetor 2017".

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të BKT datë 13 gusht 2018, miratoi rezolutat Nr. 2 dhe 3 si më poshtë:

- (2) Që, referuar miratimit sipas Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë datë 27.03.2018 dhe bazuar në rekomandimin e Këshillit Drejtues, pjesë e fitimit neto të pashpërndarë të vitit 2017, në shumën në Lekë 3,308,700,000 ekuivalent në USD 30,000,000, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 110.29, do të përdoret për t'u shpërndarë si dividend tek Çalik Finansal Hizmetler A.S., në cilësinë e aksionerit të vetëm të BKT. Kjo shumë do të paguhet në datën 12 Shtator 2018.
- (3) Që, referuar rekomandimit të Këshillit Drejtues, kapitali i autorizuar dhe i paguar i BKT-së, të rritet në vlerën 300,000,000 USD, nëpërmjet emëtimit të aksioneve të reja duke kapitalizuar: i) një pjesë të fitimit të pashpërndarë të vitit 2017, në shumën 1,074,025,899.19 Lekë; ii) rezerva ligjore e krijuar nga fitimi i vitit 2017, në shumën 350,975,689 Lekë, dhe iii) rezerva e përgjithshme krijuar nga fitimi i vitit 2017, në shumën 1,403,902,755 Lekë, total shuma (i+ii+iii) ekuivalenti në USD 25,649,690.3, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 110.29.